



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 3204/1 Prot.

Vlorë, më 21/10/2021

VENDIM Nr.109

Sot, më datë 21/10/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, i mbajtur në ngarkim të subjektit **“Fatos Likaj”** me ID H31018057J, me banim në Patos (Lagjja “Naftëtari”, Ndërtesa 64), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të konstatimit me nr.3204 Prot., datë 20/10/2021, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

KONSTATOVASE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.7938/14 Prot., datë 08/10/2021, protokolluar me Tonën me nr.1362/9, datë 11/10/2021, me lëndë *“Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Plani i Veprimt” për auditimin e kryer në Doganën Vlorë*. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, u hartua “Plani i Punës” me nr.1362/10 Prot., datë 18/10/2021, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në kontrollin dhe verifikimin e deklaratës doganore IM.4 R 13411, datë 09/12/2019, me të cilën nga ana e Subjektit “Fatos Likaj” me ID H31018057J, e përfaqësuar nga Agjensia Doganore “Gad.Universi” me kod J 102, është deklaruar artikulli (malli) “Karel i përdorur skafi spoletto basco kar”, vitprodhimi 2011, me peshë neto 2.800 kg, klasifikuar në kodn tarifor *8716*. Ky artikull është deklaruar nga ana e subjektit me vlerën 0.36 Euro/kg, ndërkohë, në zbatim të nenit 70 të Kodit Doganor, si dhe historikut të këtij artikulli, me qëllim unifikimin e vlerësimit doganor, ky mall duhej të vlerësohej me vlerën 0.7 euro/kg.

Nuk mund të kundërshtohet fakti se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacionin në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar është vlera e paguar për mallin lëndor, mirëpo, në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit, është vlerësuar nga organi konstatues si provë e pamjaftueshme, për arsye se në dokumentacionin e deklaratës doganore,

munjon swifti bankar, kontrata e shitblerjes e lidhur midis eksportuesit dhe importuesit për çmimet e mallit, kushtet dhe mënyrën e pagesës së mallit, dëshmitë mbi mënyrën e porosisë së mallit, kushtet e dërgesës etj, andaj edhe nuk mund të veprohet ndryshe, që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar, pasi subjekti, nuk ka paraqitur dokumentacion të besueshëm dhe të kompletuar për të provuar se çmimi i deklaruar është çmimi real i paguar me mallin lëndor kontestues dhe në rastin konkret, vlera e deklaruar nuk do të pranohet si vlerë reale e paguar për mallin lëndor kontestues, me arsyet e cekura më lart. Për këto arsye, pas marrjes në shqyrtim të rekomandimit të lartpërmendur, nga ana e grupit të kontrollit, është mbajtur Proces – Verbal i konstatimit nr.3204 Prot.. datë 20-10-2021.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III “Vlera për qëllime doganore” neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave, V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”.

V E N D O S A :

- Subjekti “Fatos Likaj” me ID H31018057J, me banim në Patos, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 26.347 (njëzetegjashtëmijë e treqindedyzetëshekë) lekë, për deklaratën doganore IMP- 4 me numër R 13411, datë 09/12/2019.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës I të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Fatos Likaj” me ID H31018057J, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Kosta Vjero

